

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin për të mitur të përbërë nga gjyqtarët Have Haliti, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.Z., nga Podujeva, për shkak të veprës penale keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç nga neni 198 par 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PM.nr.348/2016, të datës 07.02.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 25.08.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PM.nr.348/2016, të datës 07.02.2017, **vërtetohet.**

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PM.nr.348/2016, të datës 07.02.2017, është shpallur fajtor i akuzuari A.Z., për shkak të veprës penale keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç nga neni 198 par 1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim në kuptim të nenit 47 të KPK, i është zëvendësuar me dënimin me gjobë në shumën prej 1.800 (njëmijë e tetëqind) €, të cilin dënim është obliguar që ta paguajë në 3 (tre) këste, brenda një viti, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë, do të zëvendësohet në dënimin me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 15 (pesëmbëdhjetë) €.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara ... , nuk ka parashtuar kërkesë pasurore-juridike.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i lartë me burgim.

Përgjigje në ankesë të prokurorisë ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit A.Z., av. S.M., duke propozuar që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPAM/I.Nr.60/2017, të datës 07.08.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i lartë me burgim.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e prokurorisë, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, nuk është e bazuar.

Me qenë se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale e cila i vihet në barrë, mirëpo dënimi i shqiptuar nuk është adekuat me peshën e veprës penale të kryer dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit, ngase gjykata e shkallës së parë i ka shqiptuar dënimin nën minimumin e paraparë ligjor.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, andaj, duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, kolegji vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes se vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka patur sjellje korrekte në gjykatë, se ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale, se asnjëherë më parë nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin, se kanë kaluar më shumë se gjashtë vite nga kryerja e veprës penale, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj, në prani të këtyre rrethanave, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR. nr.378/2017 të datës 25.08.2017

Bashkëpunëtori profesional
Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Have Haliti

Abdullah Ahmeti